



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.144/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, dega në Mitrovicën e Veriut, për shkak të vendosjes së posterave në hapsira publike dhe në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lista Serbe, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 450.00 (katërqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 09.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në Prishtinë, me të cilën pretendohet se me datë 06.10.2017, në rrugën e Krajl Peter në Veri të Mitrovicës, kanë hasur në poster nga subjekti politik Lista Serbe të vendosur në hapësirë publike dhe atë në shtyllë publike dhe pritore të autobusëve.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.10.2017, subjekti politik Lista Serbe, thekson se kanë ndërmarr masat korrektuese dhe kanë larguar materialin promovues nga lokacionet e cekura në Mitrovicën e Veriut. Gjithashtu Lista Serbe ka theksuar se distancohen nga vendosja e kundërligjshme e materialeve promovuese dhe se lidhur me këtë çështje do të zhvillojnë konsultimet në ditët e ardhshme me aktivistet e saj.

Si dëshmi ka bashkangjitur dy fotografi ku shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotot e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për kryetar komune nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, janë vendosur në hapësirë publike dhe atë në shtyllë publike dhe pritore të autobusëve, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve, dhe slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në objekte dhe në rrugët publike.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lista Serbe, është shkëlur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, nga subjekti politik Lista Serbe, është i vendosur në vendin i cili nuk është i dedikuar për vendosjen e posterave.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lista Serbe, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në objekt dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar janë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.144/2017 më datë 10.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haxhiu



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.